

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KUVENDI KOMUNAL MITROVICË

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	642-25-2807-2-1-1
Nr i brendshëm	642/25/013/211

Sa i përket tenderit për: **Mirëmbajtja, ngritja dhe revitalizimi i sipërfaqeve të gjelbëruara dhe parqeve në qytet**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.SH. Ambienti G -Gani MLINAKU BI-
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Parku Fehmi dhe Xhevë Lladrovci
(Adresa)

Mitrovicë

40000

(Vendi)

(Kodi postar)


+049 174 911; 044 174-911
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Gani Mlinaku
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

AmbientiG@gmail.com
(Adresa elektronike)

12.06.2025
(Data e parashtrimit të kërkesës)


(Nënshkrimi dhe vula)

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

Prishtinë

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 10.04.2025

Data e hapjes së ofertave: 08.05.2025

Njoftimi mbi vendimin dt.29.05.2025

Kërkesë për rishqyrtim: 23.04.2025

Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 03.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ Jo ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së-Qëllimi

Neni 7 i LPP-së-Barazia dhe Trajtimi/Jo-Diskriminimi

Neni 27 i LPP-së-Dosja e Tenderit

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 69 i LPP-së-Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 17.7 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

Neni 25 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Neni 24.7 Rregullore nr 002/2024 për Prokurim Publik

Neni 40 Rregullore nr 001/2022 për Prokurim Publik

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.



Ankesa per OSHP
-Gani Mlinaku -12.01

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt.10.04.2025, kurse hapja e ofertave është bërë me datë. 08.05.2025, ku kanë marr pjesë gjithsejtë tre operator ekonomik.

Njoftimi mbi vendimin është bërë me dt. 29.05.2025, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik “Eing Com SHPK” me çmim të peshuar prej **8.90 €**, kurse ne kemi ofertuar me çmim të peshuar prej **1.04 €**.

Ne jemi eliminuar me arsyetimin si më poshtë:

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj nuk plotësonte kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit si vijon:

Ju si OE: **Gani Mlinaku B.I. PARKU FEHMI DHE XHEVË LLADROVCI, MITROVICË 810559263.**

TEK ANEKSI 7-LISTA E PAISJEVE POZICIONI 3-Cisternë minimum 7000 litra për ujitjen e gjelberimit dhe drunjeve me vetëmbushje dhe vetëshkarkues- Gjatë shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit të ofertës së bashkangjitur nga ana jua është vërejtur se mungon një nga pajisjet thelbësore të kërkuara nga autoriteti kontraktues, e specifikuar në dosjen e tenderit - Cisternë minimum 7000 litra për ujitjen e gjelberimit dhe drunjeve me vetëmbushje dhe vetëshkarkues. Në vend të pajisjes së kërkuar, keni bashkangjitur një pajisje tjetër alternative si **(Rimorkio bujqësore për shpërndarjen e urinës së bagëtive në toka pjellore)**, e cila nuk përputhet me specifikat teknike dhe kërkesat e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit. Ky zëvendësim i pajisjes nuk është i pranueshëm, pasi ndryshon funksionalitetin apo karakteristikat teknike të përcaktuara qartë nga Autoriteti kontraktues dhe si e tillë nuk mund të konsiderohet si ekuivalente apo zëvendësuese e vlefshme pasi që nuk ka librezë të qarkullimit valid.

Po ju paraqesim Kërkesën e Autoritetit Kontraktues tek Dosja e Tenderit tek Aneksit 7 – Lista e Paisjeve.

3	Cisternë minimum 7000 litra për ujitjen e gjelberimit dhe drunjeve me vetëmbushje dhe vetëshkarkues	1 Copë	Me librezë të regjistrimit valid
---	---	--------	----------------------------------

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues, ka arritur në përfundimin se oferta e paraqitur nga operatori ekonomik Gani Mlinaku B.I. konsiderohet si i papërgjegjshme, meqenëse nuk përmbush kërkesat e parashtrura në Dosje të Tenderit dhe Njoftim për Kontrat.

Ky vlerësim bazohet në rregullat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentacionin standard të prokurimit dhe në përputhje me parimet e transparencës, konkurrencës së drejtë dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Sa i përket arsyes së eliminimit, ju sqarojmë se kjo arsye është plotësisht e pa pabazuar dhe e paqëndrueshme.

Fillimisht sqarojmë se në dosje të tenderit tek neni 9.1&9.2 i FDT-së në lidhje me pajisjet është kërkuar:

Kërkesa 5. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.

Dëshmia 5.Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit valide, ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj). Vëmendje! Në rast se O.E. nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshje për marrjen me qira te pajisjeve në emër të këtij aktiviteti, e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen deri ne përfundimin e plote te shërbimeve. Kontrata ose marrëveshja duhet të jetë e përgaditur nga një avokat

i licencuar në Odën e Avokatëve të Kosovës në prani të dy palëve, apo mund të jetë e përgaditur nga OE pjesëmarrës, por me kusht që vërtetimi i dokumentit të bëhet në zyrën e noterit sipas nenit 47.2 të Ligjit të Noterisë.

Tek lista e pajisjeve tek Aneksi 7 është kërkuar.

ANEKSI 7. LISTA E PAISJEVE

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)	Sasia që ofron ofertuesi	Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit valide, ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj). Vëmendje! Në rast se O.E. nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshje për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete në emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët, Kontrata ose marrëveshja duhet të jetë e përgaditur nga një avokat i licencuar në Odën e Avokatëve të Kosovës në prani të dy palëve, apo mund të jetë e përgaditur nga OE pjesëmarrës, por me kusht që vërtetimi i dokumentit të bëhet në zyrën e noterit sipas nenit 47.2 të Ligjit të Noterisë.
1	<u>Kamionet per transport të materialit</u>	1 copë		
2	Traktor minimum 6 ton I paisur me kardan para dhe kardan mbrapa per kyqje te paisjeve percjellese per kryerjen e sherbimeve	1 copë		
3	Cisternë minimum 7000 litra për ujitjen e gjelbërimit dhe drunjëve me vetëmbushje dhe vetëshkarkues	1 Copë		

Në lidhje me këtë kërkesë, ne kemi ofruar dëshmi për cisternën për ujitjen e gjelbërimit dhe drunjëve me vetëmbushje dhe vetëshkarkues 700 litra por që kjo cisternë është pjesë aksesore e traktorit ose kamionit dhe nuk ka librezë sepse nuk regjistrohet. Kjo cisternë është e posaçme për ujitje të gjelbërimit dhe drunjëve edhe nëpër hapësira të ngushta dhe specifike, pra është adekuate për këtë tender dhe sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Kjo pajisje është ofruar sipas kërkesës së dosjes së tenderit konkretisht të përcaktuar në nenin 9.1&9.2 të FDT-së dhe sipas listës se pajisjeve sipas nenit 7.

Autoriteti kontraktues me dt.28.04.2025 ka ngrit në sistem **formularin B54** për korrigjim të gabimeve tek njoftimet, si më poshtë:

B05 Njoftim per Kontrat

Kodi i dokumentit: 2025/642-25-2807-2-1-1/B05-0007772

10.04.2025 16:39

Hape:

Ueb faqja

Dokument PDF

B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara

Kodi i dokumentit: 2025/642-25-2807-2-1-1/B54-0009144

28.04.2025 10:24

Hape:

Ueb faqja

Dokument PDF

Në këtë formular (B54) janë bërë disa ndryshime nw lidhje me punwtorwt, Iso etj, por nuk ka pas ndryshime në lidhje me dëshmitë e makinerive e as të cisternës, **ju lutem analizojeni formularin për korrigjim.**

Dispozitat e mëposhtme të RRPP Nr.001/2022 e përcaktojnë qartë se formulari B54 duhet të publikohet me ndryshime:

23.13 Nëse gabimet vërehen pasi të jetë publikuar tenderi, duhet të përdoret procedura përmirësimit të gabimeve (formulari B54) për të adresuar gabimet dhe të cilat duhet publikuar në sistem të prokurimit elektronik.

24.7 Nëse para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, bëhet e nevojshme nga AK që të ndryshohet ose përmirësohet Dosja e Tenderit, Lista e çmimeve, të dhënat në njoftim për kontratë, të bëhet zgjatja e afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, atëherë ndryshimet ose përmirësimet nga AK bëhen vetëm duke përgatitur dhe publikuar *Njoftimin për informata shtesë ose përmirësim gabime* duke përdorur formularin standard B54.

Në këto dispozita përcaktohet që nëse ka ndryshime duhet të përgatitet dhe publikohet *Njoftimin për informata shtesë ose përmirësim gabime* duke përdorur **formularin standard B54**, kurse në këtë rast është publikuar formulari B54 por që tek ky formular nuk ka asnjë ndryshim sa i përket kërkesës dhe dëshmive për pajisje dhe për cisternën.

Tek dokumenti shtojca, autoriteti ka ngritur në sistem tri dokumente të tjera që ka njoftuar OE për sqarime dhe njoftim të korrigjimit, mirëpo nuk ka të ngritur në sistem njoftim për informata shtesë për korrigjim të dosjes, shih më poshtë:

Dokumenti shtojca

Dokumenti shtojca

Njoftim sqarues për OE...pdf

07.05.2025 15:57

Hape:

Shkarko të gjithë dokumentacionin

Shqip

1?

Dokumenti shtojca

Njoftim për Korrigjim-Letra Standarde.pdf

30.05.2025 09:39

Hape:

Shkarko të gjithë dokumentacionin

Shqip

1?

Dokumenti shtojca

Vendim mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit.pdf

03.06.2025 14:54

Hape:

Shkarko të gjithë dokumentacionin

Shqip

1?

Në këtë rast korrigjimet e bëra me formularin B54 janë të vlefshme, por që në këtë korrigjim nuk ka pas ndryshim të kërkesës dhe dëshmive për pajisje, prandaj duhet të merret parasysh **vetëm formulari B54** dhe ndryshimet që janë bërë në këtë formular.

Autoriteti kontraktues me rastin e eliminimit tonë është thirr në ndryshimet në dosje të tenderit, e që dosja është ngritur në sistem me dt. 28.04.2025 e ku janë bërë ndryshime vetëm tek lista e pajisjeve në lidhje me pajisjet, shih me të kuqe ndryshimin e bërë në dosje të tenderit, ku tani është shtuar që pajisjet me nr. rendor 1, 2, 3 të ofrohen Me librezë të regjistrimit valid:

1	<u>Kamionet per transport të materialit</u>	1 copë	Me librezë të regjistrimit valid
2	Traktor minimum 6 ton I paisur me kardan para dhe kardan mbrapa per kyqje te paisjeve percjellese per kryerjen e sherbimeve	1 copë	Me librezë të regjistrimit valid
3	Cisternë minimum 7000 litra për ujitjen e gjelberimit dhe drunjeve me vetëmbushje dhe vetëshkarkues	1 Copë	Me librezë të regjistrimit valid

Pra ndryshimi në dosje të tenderit është bërë vetëm tek aneksi 7 dhe vetëm për këto tri pajisje ku tani është shtuar fjalia-Me librezë të regjistrimit valid.

Ligjërisht ndryshimet e dosjes së tenderit bëhen dhe janë të vlefshme nëse bëhen me formularin B54 e më pastaj, e nuk mund të merren parasysh ndryshimet nëse këto ndryshime nuk janë vendos tek formulari B54 e janë vendos tek lista e pajisjeve tek dosja e tenderit. Në këtë rast autoriteti kontraktues ka vënë në lajthitje operatorët ekonomik pasi që librezat nuk i ka kërkuar tek formulari i korrigjimit B54 e as tek njoftimet sqaruese nuk ka vendos ndonjë njoftim por librezat i ka kërkuar me ndryshim vetëm tek lista e pajisjeve tek dosja e tenderit.

Në këtë rast vlerësimi i ofertave është dashur të bëhet konform dosjes së tenderit të publikuar në fillim **dhe konform ndryshimeve tek formulari B54** e jo me ndryshimet e listës së pajisjeve e që këto ndryshime nuk janë tek formulari B54.

Në lidhje me këto ndryshime vetëm tek dosja (aneksi 7) ne askund nuk kemi vërejt se është bërë ndonjë pyetje nga ndonjë OE apo se ndonjë OE ka pasur ndonjë paqartësi, mirëpo ndryshimi i bërë tek aneksi 7 i dosjes pa u përfshi në formularin B54, dyshojmë shumë se është bërë me të vetmin qëllim për të favorizuar OE e rekomanduar për kontratë dhe kjo sipas

dyshimeve tona ka ndodh në momentin kur AK-së është informuar se ky OE ka një autocisternë (jo cisternë adekuate sipas kërkesës fillestare) me librezë të regjistrimit, sepse cisterna siç është kërkuar në dosjen fillestare të tenderit nuk regjistrohet.

Nga të gjitha dëshmitë kuptohet qartë se ne kemi ofertuar sipas dosjes së tenderit dhe sipas formularit B54 për korrigjim ku kemi ofruar dëshmi për cisternën sipas kësaj kërkesë pa librezë të regjistrimit sepse kjo cisternë nuk regjistrohet. Pra në dosje të tenderit dhe në formularin B54 nuk është kërkuar librezë e regjistrimit për cisternën.

Në dosjen fillestare shkruan qartë se pajisjet që nuk mund të regjistrohen duhet dëshmohen me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj). Dhe ne këtë e kemi dëshmuar. Mirëpo edhe te dosja e tenderit tek neni 9.1&9.2 i FDT-së kjo kërkesë nuk është ndryshuar, pra ka mbetë njëjta por vetëm tek aneksi 7 është shtuar fjalia Me librezë të regjistrimit valid.

- Neve fillimisht autoriteti kontraktues na ka kërkuar sqarime shtesë me dt.21.05.2025 në lidhje me kontratën e punës për punëtorin Ferki Ademi dhe për dy pajisje duke përfshirë edhe cisternën ku na është kërkuar Librezen e regjistrimit.

Ne me dt.26.05.2025 i kemi kthyer përgjigje duke i sqaruar dilemat për punëtorin në fjalë, ndërsa sa i përket librezës së cisternës e kemi sqaruar se në dosje është kërkuar që pajisjet që nuk mund të regjistrohen duhet të dëshmohen me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj) dhe ne e kemi plotësuar këtë kërkesë pasi që cisterna e ofruar nga ne nuk regjistrohet.

Me sqarime shtesë ne kemi bashkangjitur edhe një dëshmi tjetër për një pajisje kamion cisternë 1000 litra, ku kemi bashkëngjitur marrëveshjen për marrje me qira e cila marrëveshje është e përpiluar tek zyra e avokatisë sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe ka regjistrim valid.

Pra edhe kjo pajisje duhet të merret parasysh sepse shumë lehtë mund të vërtetohet në mënyrë objektive se ka ekzistuar marrëveshja më herët dhe po ashtu të gjitha dëshmitë tjera janë evidente dhe me këtë rast këto dëshmi janë sipas nenit 72.3 të LPP-së.

Në secilin variant ne e plotësojmë kërkesën e dosjes së tenderit, prandaj arsyeja e eliminimit është e pa bazuar dhe e paqëndrueshme.

Bashkangjitur me ankesë keni edhe dëshmitë për kamionin cisternë më dëshmitë përkatëse.

- Sa i përket OE të rekomanduar për kontratë, ne kemi pas qasje në dokumentet e tij dhe kemi arritur në përfundim se ky OE është i papërgjegjshëm me arsyet si më poshtë:

1] .O.E. i rekomanduar për kontratë dorëzon dokumentacionin për pozicionin 3- Anexi [Auto Cisternë]-jo cisternë siqë kërkohet në DT te ky Anex,kurse neve nuk na pranon Auto Cisternën me sqarime shtesë sipas nenit 72 te LPP- me rexhistrim valid dhe kontratë para publikimit te Njoftimit për kontratë. [dok 1]

2].Kontrata për shitblerjen e Paisjeve “Rimorkio bujqësore me Sistem [ngarkim-shkarkim]-ngjyra e kuqe-hiri “ O.E. i rekomanduar për kontratë ka ofruar kontratë për shitëblerje e cila as nuk është e vertetuar te Avokati i Licencuar nga OAK as e noterizuar siqë është kërkuar te Anexi 7--[Kontrata ose marrëveshja duhet të jetë e përgatitur nga një avokat i licencuar në Odën e Avokatëve të Kosovës në prani të dy palëve, apo mund të jetë e përgaditur nga OE pjesëmarrës, por me kusht që vërtetimi i dokumentit të bëhet në zyrën e noterit sipas nenit 47.2 të Ligjit të Noterisë].Paisjet dhe marrëveshtja është

në emer të NNT EING-Com kurse O.E ka konkuruar me EING Com Shpk [nuk ka marrëveshje].

Më këto dëshmi vërtetohet saktë se ky OE është i papërgjegjshëm dhe në asnjë mënyrë nuk ka mundur të shpallet fitues i këtij tenderi por autoriteti kontraktues e ka favorizuar këtë kompani edhe pse e njëjta ka mënagësi e poashtu ka çmim më të lartë se sa oferta jonë.

Për të qenë një ofertë e përgjegjshme duhet që tenderi të përputhet plotësisht me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe kjo përcaktohet me nenin 59.4 të LPP-së.

3]. Kontrata për shitëblerjen e “Fryrse për gjethe me benzinë-marka Stihl-3 copë” O.E. i propozuar ka ofruar kontratë për shitëblerje e cila as nuk është e vertetuar te Avokati i Licencuar nga OAK as e noterizuar siç është kërkuar te Anexi 7-[Kontrata ose marrëveshja duhet të jetë e përgaditur nga një avokat i licencuar në Odën e Avokatëve të Kosovës në prani të dy palëve, apo mund të jetë e përgaditur nga OE pjesëmarrës, por me kusht që vërtetimi i dokumentit të bëhet në zyrën e noterit sipas nenit 47.2 të Ligjit të Noterisë].Paisjet dhe marrëveshja është në emer të **NNT EING-Com** kurse O.E ka konkuruar me **EING Com Shpk** [nuk ka marrëveshje].

4]. Te kontratat e realizuara në 3 vitet e fundit O.E. ka dorëzuar kontrata ku 60% deri 70% nga vlera e këtyre janë kontrata për mirëmbajtje te rrugëve ”Mirëmbajtje verore dhe Dimërore”(asfalt dhe mirëmbajtje dimërore) [dhe te gjitha kontratat janë konzorciume me dy ose tre partner të konzorciumit-nuk dihet vlera e punëve/shërbimeve të kryera nga O.E. i propozuar EING com shpk] por shumë vlerë e vogël mos te themi simbolike“mirëmbajtje te gjelëbrimit,revitalizim te sipërfaqeve te gjelbruara”siç është njoftimi për kontratë ku sipas verifikimit te pershkrimit te çmimeve te siguruara te gjitha me i përmbledh nuk arrijnë shumën as 400.000,00 € në total.Ne nuk e kuptojm Zyren e Prokurimit se si përfshihet kërkesa për kontratat e realizuara **“mirëmbajtja e rrugëve”** ku në përshkrim të çmimit nuk ekziston asnjë pozicion i tillë për mirëmbajtje të rrugëve.

5].Duke analizuar përshkrimin e çmimeve te OE të rekomanduar për kontratë është për tu habitur se si komisioni i vlerësimit dhe Zyra e Prokurimit nuk e kanë analizuar dhe kanë vërejtur se Operatori i rekomanduar ka manipuluar me çmime te fryera ne pozicionet te cilat me se shumti realizohet në kontratën në fjalë ”poz:1.2 Përkujdesja për sipërfaqet e gjelbëruara ku hyjn:Kositja e rregulltë e barit,bartja e barit deri në deponi sipas kerkeses dhe nevojave te AK ”. ku OE i rekomanduar ofron çmimin 0.24 euro cent për m² kurse ne si O.E. i papërgjegjshëm për AK kemi ofertuar me çmimin 0.14 euro cent për m².

Nga këtu vërehet se as AK as Komisioni i vlerësimit dhe as Zyra e Prokurimit nuk janë fare te interesuar te analizojnë çmimet se si ofertojnë OE, me çfarë çmimesh ku vetëm në pozicionin e cekur OE i rekomanduar oferton me çmimin dyfish më te lartë se çmimi ynë, që do te thotë më pak punë me kosto dyfish më te lartë.

Duke pasur parasysh të gjitha këto dëshmi vijmë në përfundim se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet nga konkurrenca e jo të favorizohet duke u shpall fitues i këtij tenderi pa i plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, autoriteti kontraktues e ka nxjerr me dt.05.06.2025, mirëpo nuk ka argumentuar në asnjë mënyrë vendimin e saj.

Përgjigjet e AK-së në vendimin për refuzim kanë qenë si më poshtë:

PRETENDIMI ANKIMOR 1):

O.E. i propozuar për kontratë dorëzon dokumentacionin për pozicionin 3 – Anex (Auto Cistern) – jo cistern siç kërkohet në Dosjen e Tenderit të ky Anex, kurse neve nuk na pranon Auto Cisternën pas kërkesës për sqarime shtesë sipas nenit 72 të LPP-së me regjistrim validë dhe kontratë para publikimit të njoftimit për kontratë (dok 1).

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 1 ANKIMORE NDAJ OE “Gani MLINAKU B.I.”:

Me rastin e publikimit të këtij aktiviteti të prokurimit AK ka vepruar në tërësi sipas LPP-së dhe nuk ka shkelë asnjë dispozitë ligjore në lidhje me nenin 7, nenin 59.2 dhe 59.4 të LPP-së, sepse AK ka kryer vlerësimin e tenderëve konform dispozitave të parapara me legjislacionin për prokurim publik. Prandaj pranimi i një dokumenti i cili është ndryshe me kërkesën fillestare të përcaktuar në dosjen e tenderit si dhe ndryshon komplet paisja me të cilën OE ka ofertuar në ofertën e tij, rrjedhimisht pranimi i këtij dokumenti bjen në kundërshtim me nenin 59.2 të LPP-së sepse dokumenti si i tillë përbenë ndryshim material të tenderit, për më tepër neni 59.2 përcakton: *(2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues).* Gjithashtu për ta sqaruar me mirë neni 45.19 i RRPP-së përcakton: *(Neni 59.4 i LPP-së gjithashtu lejon autoritetin kontraktues që të pranojë ofertat, në raste të gabimeve ose paqartësive dhe në raste të devijimeve të vogla. Në të dyja rastet është një kusht që aspektet materiale të njoftimit për kontratë / dosjen e tenderit nuk janë prekur).*

Mos marrja në konsideratë e këtij dokumenti të cilin ju e keni paraqitur është bërë sipas nenit 7 të LPP-së në mënyrë që të gjitha ofertat të trajtohen në mënyrë të barabartë.

Andaj, Refuzohet pretendimi i juaj si i pabazuar.

Kjo përgjigje është jo profesionale dhe jo në harmoni me dëshmitë që janë ofruar nga ana jonë. Fillimisht AK-së nuk përgjigjet për pretendimin tonë se tek formulari B54 nuk ka pas ndryshim sa i përket kërkesave të makinerive dhe nuk e merr parasysh cisternën që ne e kemi ofruar sipas kërkesës së dosjes së tenderit, mirëpo e njëjta është fokusuar vetëm tek pajisja që ne e kemi ofruar me sqarime shtesë duke u munduar të cilësojë këtë veprim si ndryshim material. Pra kemi shmangie të dhënies së përgjigjes në raport me pretendimin ankimor. Me vetë faktin se nuk kemi marr përgjigje për ndryshimet e formularit B54 nënkuptohet se AK-së na ka diskriminuar neve duke na eliminuar pa të drejtë dhe në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit.

Sa i përket pretendimit **Nr.3 AK-së** është përgjigjur si më poshtë:

PRETENDIMI ANKIMOR 3):

Kontrata për shitëblerjen e paisjeve “Fryrëse për gjethe me benzinë – marka Stihl – 3 copë ”O.E. i propozuar ka ofruar kontratë për shitëblerjen e cila as nuk është e vërtetuar te Avokati i Licencuar nga OAK as e noterizuar siq eshte kerkuar te Anex 7 [Kontrata ose marrëveshja duhet të jetë e përgaditur nga një avokat i licencuar në Odën e Avokatëve të Kosovës në prani të dy palëve, apo mund të jetë e përgaditur nga OE pjesëmarrës, por me kusht që vërtetimi i dokumentit të bëhet në zyrën e noterit sipas nenit 47.2 të Ligjit të Noterisë.]

Paisjet dhe marrëveshja është në emër të NNT EING COM kurse OE ka konkuruar me EING COM SHPK [nuk ka marrëveshje] [dok 2]

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 3 ANKIMORE NDAJ OE “Gani MLINAKU B.I.”:

Ky pretendim për arsye se kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë e qartë dhe e formuluar mirë, gjithashtu për këtë çështje edhe janë dhënë sqarime gjatë fazës së tenderimit, prandaj OE i rekomanduar për kontratë i plotson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, pasija e ofruar është në pronesi të OE të rekomanduar për kontratë, ku si dëshmi është ofruar kontrata e shitëblerjes për paisjen në fjalë dhe për më tepër sipas nenit 56.3 të LPP-së, asnjë OE nuk mund të diskualifikohet nga procedura e prokurimit për një kërkesë që AK nuk e ka përcaktuar në dosjen e tenderit.

Sa i përket emërimit të OE të rekomanduar ju sqarojmë se sipas Çertifikates së biznesit rezulton se ka të bëjë me ndryshim emrit të biznesit dhe është vazhdim i biznesit të mëhershëm, prandaj paisjet e blera në emër të NNT EING COM janë në pronësi të EING COM SH.P.K.

Andaj, Refuzohet pretendimi i juaj si i pabazuar.

Edhe nga kjo përgjigje kuptohet favorizimi i OE të rekomanduar për kontratë dhe diskriminimi i kompanisë tonë, pasi që pajisjet të cilat janë në pronësi të kompanisë tonë nuk i merr parasysh si dhe dëshmitë e tera, ndërsa në këtë rast ekziston shitblerja me kompaninë tjetër (NNT Eing Com) e jo me kompaninë ofertuese Eing Com SHPK.

Sa i përket pretendimit për kontratë të OE të rekomanduar për kontratë AK-së vetëm është përgjigjur se e tejkalon vlerën e kërkuar mirëpo në asnjë mënyrë nuk ka dëshmuar të kundërtën e pretendimit tonë ankimor.

Në lidhje me pretendimin Nr.5 përkitazi me çmimin e ofruar më shtrenjtë nga an e OE të rekomanduar për kontratë për pozicionin 1.2 AK-së është përgjigjur si më poshtë:

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 5 ANKIMOR NDAJ OE “Gani MLINAKU B.I.”:

Sa i përket përcaktimit të çmimeve OE janë të lirë të ofrojnë çmime për pozicionet e caktuara sipas llogaritjeve të tyre dhe gjithnjë duke pas në konsideratë kostot totale për arsye se një OE lokal mund të rezultojë më një çmim më të ulët se një OE i cili ofertonë nga një qytet tjetër për shkak të shpenzimeve dhe distancës territoriale.

Nga kjo përgjigje kuptohet se AK-së ka marr rolin e avokatit mbrojtës të OE të rekomanduar për kontratë duke e arsyetuar se përse ka ofruar çmim më të shtrenjtë në këtë pozicion. Autoriteti kontraktues në vend se të analizojë mundësinë e ruajtjes së buxhetit më shumë merret me mbrojtjen e OE të rekomanduar për kontratë, prandaj me këtë rast edhe mund të kemi dëmtim të buxhetit.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, e po ashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Autoriteti kontraktues nuk ka shfrytëzuar drejtë nenin 59 dhe 72 të LPP-së sepse nuk ka marr për bazë dëshmitë e ofruara për kaionin cisternë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, dhe dyshimet tona të ngritura, konsiderojmë se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe si i tillë është i papërgjegjshëm dhe në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk është dashur të rekomandohet për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “*Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*”, mirëpo AK-së nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, sepse neve jemi eliminuar pa asnjë bazë ligjore dhe pa asnjë dëshmi konkrete, ndërsa AK-së rekomanduar për kontratë OE i cili është i papërgjegjshëm.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të nxjerr:

VENDIM

- I. APROVOHET**, e bazuar ankesa e OE N.SH. **Ambienti G -Gani MLINAKU BI**
- II. ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale llogariten duke përfshi pregaditjen e DT, sigurimin e tenderit që ka kosto dhe paisjet e blera dhe te paguara posaqërisht për procedurën në fjalë dëmi është dikun 100.000,00 €.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*